REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4254/2 Prot

Rrëshen, më 01 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 75 datë 25. 09. 2026
PËR
"MIRATIMIN E KTHIMIT TË RRUGËS KËMBËSORE NË RRUGË AUTO, ME GJATËSI RRETH 92 ML (0.092 KM), QË LIDH LAGJEN "MUSPIT", FSHATI BISAK, ME RRUGËN EKZISTUESE "BISAK 03210005", NJËSIA ADMINISTRATIVE FAN, 4608", BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, nenit 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" *të ndryshuar*; neni 6, gërma i) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" *të ndryshuar*, Urdhërit nr. 353, datë 02.07.2026, të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin në terren", relacionin nr. 4254 prot, datë 21.09.2026 së bashku me projekt - vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në Këshillin e Bashkisë, pas diskutimeve të anëtarëve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Miratimin e kthimit të rrugës këmbësore në rrugë auto, me gjatësi rreth 92 ml (0.092 km), që lidh lagjen "Muspit" fshati Bisak, me rrugën ekzistuese "Bisak 03210005", njësia administrative Fan, 4608, Bashkia Mirditë

   - Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës është rreth 276 m2, me gjatësi rreth 92 ml (0.092 km) dhe gjerësi mesatare rreth 3.0 m, sipas planvendosjes së miratuar.

2. Planvendosja për miratimin e kthimit të rrugës këmbësore në rrugë automobilistike Sh. 1:1000, Relacioni nr. 4254 prot, datë 21.09.2026, bashkëlidhur, *pjesë përbërse këtij vendimi*

3. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë

4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e Bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë (APPMM)

5. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Bashkia Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, APPM-Mirditë dhe njësia administrative Kaçinar).

Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

KRYETAR

Aleksandër PICAKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4254/1 **Prot** **Rrëshen më,** 21.09. **2026**

P/VENDIM

Nr. 95 **, datë** 21 **.** 09 **. 2026**

PËR

"MIRATIMIN E KTHIMIT TË RRUGËS KËMBËSORE NË AUTO, QË LIDH "MUSPIT" ME RRUGËN "BISAK 03210005" BISAKË, NJËSIA ADMINISTRATIVE FAN 4608"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (*të ndryshuar*), neni 6, gërma "i", të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", (*të ndryshuar*), Urdhërit nr. 353, Nr. 2534/1 Prot datë 02.07.2026, i Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e grupiut të punës për verifikim në terren", projekt –vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kthimit të rrugës këmbësore në auto, që lidh lagjen MUSPIT me rrugën "BISAK 03210005" BISAKË, Njësia Administrative FAN 4608.

- Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës është rreth 276 m^2, me gjatësi L= 92 mL dhe gjerësi 3.00 mL, sipas planvendosjes së miratuar..

2. Planvendosja për miratimin e kthimit të rrugës nga këmbësore në automobilistike Sh. 1:000, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.
4. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.

5. Për ndjekje dhe zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Bashkia Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, APPM-Mirditë dhe Njësia Administrative FAN).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" (të ndryshuar)!

SEKRETARI
Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksandër PICAKU

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit: Dr. Ark. J. TUSHA

Sektori Juridik: P/Sek. L. Gjergji

K R Y E T A R I

Albert MËLYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-BASHKIA MIRDITË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4254 **Prot** **Rrëshen më,** 21.09.**2026**

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN PËR

"MIRATIMIN E KTHIMIT TË RRUGËS KËMBËSORE NË AUTO, QË LIDH LAGJEN MUSPIT ME RRUGËN "BISAK 03210005" BISAKË, NJ. ADM. FAN 4608"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (*të ndryshuar*), neni 6, gërma "i", të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", (*të ndryshuar*), Urdhërit nr. 290, Nr. 2450/1 Prot datë 11.06.2026, i Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e grupiut të punës për verifikim në terren", projekt –vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Pranë Bashkisë Mirditë janë paraqitur kërkesa për kthimin e rrugës ekzistuese këmbësore, e cila lidh lagjen MUSPIT me rrugën "BISAK 03210005"BISAKË, Njësia Administrative FAN 4608, në rrugë të kalueshme për automjete.

Në vijim të kërkesës dhe pas verifikimeve të kryera në terren nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, është konstatuar nevoja për përshtatjen e kësaj rruge, me qëllim përmirësimin e aksesit rrugor dhe lehtësimin e lëvizjes së banorëve të zonës.

Rruga objekt i këtij projektvendimi ka një gjatësi prej 92 m, gjerësi 3.5 m, nga e cila gjerësia e trupit të planvendosjes është 3.00 m, sipas dokumentacionit dhe planvendosjes bashkëlidhur projektvendimit.

Pas realizimit të ndërhyrjes, rruga do të pasqyrohet në dokumentacionin përkatës të Bashkisë Mirditë dhe do të ndiqen procedurat administrative për regjistrimin dhe administrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të zbatueshme.

Për sa më sipër, duke vlerësuar se ndërhyrja i shërben përmirësimit të infrastrukturës dhe aksesit të komunitetit të zonës, i propozohet Këshillit Bashkiak Mirditë miratimi i projektvendimit "Për miratimin e kthimit të rrugës këmbësore në rrugë auto, që lidh lagjen MUSPIT me rrugën nr. "BISAK 03210005",BISAKË, Njësia Administrative FAN 4608".

Ing. Gjeodet A. Dedaj

Dr. DPZHT Ark. J. Tusha